




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe të nenit 58, shkronja f), të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 15, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinës, nenit 4, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E SHEFIT TË KABINETIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

- I. Vllaznim Osmani**, emërohet në pozitën e shefit të kabinetit të Komunës së Prishtinës nga data 7 Dhjetor 2021.
- II.** I emëruari do të koordinojë punët brenda Kabinetit, në përputhje me udhëzimet e Kryetarit të Komunës, ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
- III.** Orari i punës për të emëruarin përcaktohet nga Kryetari i Komunës.
- IV.** I emëruari do t'i raportojë rregullisht Kryetarit të Komunës për punën e tij.
- V.** Marrëdhënia e punës e të emëruarit si në pikën I të këtij Vendimi pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Të emëruarit;
- Drejtorisë së Financave;
- Njësisë së Personelit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

